

Konsultimet me bashkësinë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së

27. nëntor 2010.

Bratunac, Bosnjë e Hercegovinë

Konsultimet me bashkësinë lokale në Bratunac i organizoi Qendra për informim dhe ndihmë juridike (CIPP), anëtare e Koalicionit për KOMRA-në. Në takim morën pjesë 35 pjesëmarrës – viktima, anëtarë të organizatave joqeveritare, anëtarë të shoqatave të ndryshme, gazetarë dhe profesionistë që punojnë me viktimat. Fjalën hyrëse e mbajtën Milena Savić (CIPP, Zvornik, BeH), dhe Amir Kulaglic (anëtar i Këshillit Koordinues i Koalicionit për KOMRA-në) nga BeH.

Shqyrtimet e propozimeve, rekomandimeve dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:

Për numrin më të madh të viktimave nuk do të ketë dëshmitarë. KOMRA do të duhej të plotësojë normën morale dhe njerëzore që ata të dënohen edhe pas vdekjes së dëshmitarëve.

Mendoj se KOMRA do të duhej të vazhdojë këtë iniciativë, dhe se zvarritja do të ndikojë në rezultatin përfundimtar të dënimit të krimeve të luftës. Për numrin më të madh të atyre viktimave nuk do të ketë kush të dëshmojë, shumica e dëshmitarëve nuk do të jetojnë aq gjatë për të dëshmuar për të afërmit e tyre. KOMRA dhe këto shoqata, organizata të ndryshme do të duhej të vazhdojnë që së paku të plotësojnë normën morale apo njerëzore. Viktimën do të duhej kompensuar me ndonjë proces, që kryesit e krimeve të luftës të dënohen edhe pas vdekjes së tyre. Kemi gjykimin i cili është zhvilluar në Beograd, për 2.300 viktima apo më saktë për 1.300 viktima nga rajoni i Komunës së Zvornikut, gjegjësisht 1.500. Fajtori është dënuar me pesë vite burg, gjë që është trishtuese. Kështu që, ato gjykata në këtë moment janë joreale, dhe mendoj se KOMRA me aktivitetet e saj do të kontribuojë deri diku. Prandaj, nga kjo arsye, si kryetar i Shoqatës së qytetarëve të kthyer, do ta mbështesë maksimalisht këtë organizatë dhe vlerësoj se ajo do të duhej të ishte mbështetje morale për viktimat. (Omer Selimović, Shoqata e qytetarëve të kthyer në Komunën e Zvornikut, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bratunac, BeH, 27 nëntor 2010.)

Fëmijët janë viktimat më të mëdha të luftës. Propozimi për KOMRA-në është se do të duhej të hiqet nga mësimdhënia mësimi fetar dhe të aplikohet kultura për religjione, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë çfarë është feja tjetër.

Në shoqatën tonë Leptir (Flutura) në Srebrenicë kemi 276 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga Komunitet e Srebrenicës, Bratuncit, Vlasenicës dhe Shehoviqit, 30 përqind e kësaj janë pasojë e ngjarjeve të luftës. Aty fëmijët janë viktimat më të mëdha. Të gjithë flasim për të drejtat e fëmijëve. Shumë organizata joqeveritare marrin mjete materiale në emër të të drejtave të fëmijëve, ndërsa çdo ditë jemi pjesëmarrës të shkëlqeve ligjore të të drejtave të fëmijëve. Jo vetëm ata fëmijë që kanë lindë gjatë kohës së luftës por edhe ata fëmijë të cilët kanë lindë pas luftës. Të gjithë ata vuajnë. Ne si shoqatë e mbështesim KOMRA-në dhe gjithnjë do ta mbështesim, por do ta mbështesim të vërtetën (...) do të dëshiroja që një nga rekomandimet e KOMRA-së të jetë që të hiqet nga mësimi fetar, dhe të aplikohet kultura e religjionit. Që çdo fëmijë të kuptojë se çfarë është feja tjetër, ndërsa bashkësitë fetare le të merren me atë me çfarë merren. (...) Vetëm desha të them që shpresoj se në atë Komision, i cili përbëhet nga pesë anëtarë (nga BeH), do të jenë anëtarët e trajnuar për marrjen e deklaratave. Pra, nëse e shohim se është viktimë – viktimë të mos jetë vetëm viktimë edhe pas asaj bisede, dhe të mos e lëmë vetëm. Kur vjen ajo, thotë atë çfarë ka për të thënë, çfarë ka përjetuar dhe të mos e harrojmë se ekziston... dikush nuk do ta ketë të lehtë të tregojë, të deklarojë, dhe pastaj me ditë të tëra do të ketë probleme. Dhe kjo bartet edhe te familja. (Željka Katanić, Shoqata e prindërve të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara Leptir (Flutura), Srebrenicë, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bratunac, BeH, 27 nëntor 2010.)

Të afrohem, të duhem, të mos hulumtojmë së tepërmi, të mos gërmojmë më tepër. Nuk guxojmë të shpenzohemi si shoqëri.

Sikur të ishte, të punojmë në atë drejtim që të afrohem, të duhem, të mos hulumtojmë së tepërmi, të mos gërmojmë tepër... Mos mendoni se unë nuk bashkëndiejë me atë i cili i ka humbur të afërmit e tij. Unë e kuptoj atë, kjo është e saktë dhe ai ka të drejtë në atë, por nuk guxojmë si shoqëri të shpenzohemi shumë. Përndryshe unë jam njeri i cili edhe në bazë profesionale punon për afrimin e njerëzve, në pajtimin e njerëzve. Prandaj zyra ime quhet këshillimore psikologjike dhe bashkëshortore. (...) Nëse janë cekur shtetet e Jugosllavisë, atëherë nuk ka mund të ceket Maqedonia si krahinë, jo Kosova si krahinë, e jo krahina Autonome e Vojvodinës. Këtu është një gabim, pa dyshim. Është dashur të mbetet siç është thënë – pa Kosovën, apo të shkruhet Kosova dhe Krahina Autonome e Vojvodinës. Unë këtë në formularin tim e kam zgjidhur ashtu që thjesht e kam shtuar afër Kosovës, mundeni edhe ju, kam shtuar Krahina Autonome e Vojvodinës. (Dr Cvijan Đapanović, Shoqata EGO, Zvornik, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bratunac, BeH, 27 nëntor 2010.)

Gjithnjë të njëjtat organizata thjeshtë i bojkotojnë këto takime. Nuk ka arsytim pse bashkësia lokale nuk ka ardhur në konsultime.

Ne disi do të kuptohemi (organizatat joqeveritare, nënat, motrat, vëllezërit), por mendoj se nuk do të na kuptojë bashkësia lokale. Dhe me mosardhjen e tyre, ata nuk na mbështesin as neve, as KOMRA-në. (...) Mendoj se është koha e fundit (nëse duam të hyjmë në KOMRA apo nëse KOMRA do ta marrë mbështetjen e Bratuncit si qytet, bashkësisë lokale, si dhe shoqërisë civile joqeveritare) atëherë do të mund të flasim të gjithë kësi lloj tregimesh pa hezitim. Pa marrë parasysh nga cila anë vijnë. (...) Është interesante se çdo herë të njëjtit njerëz apo të njëjtat organizata në kuptim të plotë e bojkotojnë, apo e fillojnë ndonjë tregim dhe pastaj e lëshojnë takimin. Atë që dua të them, për mua, bashkësia lokale dhe të gjitha ato organizata për mosardhjen e tyre sot këtu, nuk kanë kurrfarë arsytimi. Sepse, nëse vetëm unë e përfaqësoj shoqatën time, atëherë ajo nuk mund të quhet shoqatë. (...) Propozimi im konkret është të paktën për Bosnjë Hercegovinën të jetë data 1 janar 1990. Por, me 1990 kanë filluar zgjedhjet, gjegjësisht atëherë e kemi fituar sistemin shumëpartiak. Dhe mendoj se që nga atëherë, e të mos them se që nga vitet '90, janë kryer disa vrasje të caktuara. (Hiba Ramić, Fondacioni i varrezave Bratunac '92, Bratunac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bratunac, BeH, 27 nentor 2010.)

Kosova nuk ka qenë republikë (në RSFJ). Pse do ti jepnim një milion nënshkrime për diçka që nuk e ka pranuar shteti ynë – BeH dhe RS.

Besoj se nuk ka qenë e qëllimshme në Deklaratën e pranimit në KOMRA-në. ... Në rreshtin e parafundit të pasuesit të parë janë të radhitura republikat e ish Jugosllavisë, mes tyre gjendet edhe Kosova. Unë ju lus që të dëgjohemi, të kuptohemi. Atëherë Kosova nuk ka qenë republikë. Pse ne do të duhej ti japim një milion nënshkrime për të pranuar diçka që shtetet tona nuk e kanë pranuar, BeH dhe Republika jonë e Serbisë? Unë ju lus që ti kushtoni vëmendje kësaj, dhe organizatori i këtij takimi nëse mundet, e sigurisht mundet, ta ndryshojë këtë pjesë të pasusit, gjegjësisht të nënshkrimit. Bosnja dhe Hercegovina, dhe pastaj shkruan Kosova. (...) keni thënë se i nënshtrohet aktit ynë ratifikimit. Unë dua të tërheqë vëmendjen, të angazhohem që akti të kalojë. Te ratifikimi, nuk do të kalojmë në Serbi për shkak të konstatimit se Kosova është në kapitullin e parë. Unë, vetëm po insistoj në atë që të mos na kalojë koha dhe të mos na e kthejë dikush tërë punën për shkak të saj. (Spasoje Mijatović, gazetar, Večernje novosti, Bratunac, BeH, Konsultimet me bashkësinë lokale, Bratunac, BeH, 27 nentor 2010.)